

HISTORIA E SKËNDERBEUT- Marin Barleti

Mjetet gjuhësore që i japin tekstit karakter shpjegues:

- Mjete lidhëse:

që, duke qenë se, ndaj, se

-Folje:

trajtohen, shënon, përbëhet, bazohet, vërejmë, vjen, mëton, i jep, ndajmë, mbetet, mbështetet

-Shprehje:

jo vetëm për, në kuptimin që, në këtë kuadër

-Emra:

vërtetësia, pikëpamjet, gjykimi, këndvështrimi, koncepti, burimet

-Parafjalë:

sipas, tek, nga

-Paskajorja:

për t'i shoshitur, për t'i përshkruar

Thënie me gjuhë të pasur:

- 1) Kush nga vdektarët, o kryevalltari më i lartë e më i shenjtë i Romës, o etër fort të nderuar e të fuqishëm, do të mundte, jo ta shprehte me gojë, por as ta merrte me mend lartësinë dhe madhërinë e këtij vendi dhe të kësaj selie, ku qëndroni ju?
- 2) I lumtur pra, jam unë, që po të shikoj ty sot, po të drejtoj fjalën, po të admiroj dhe s'mund të kishte gjë më të këndshme, gjë më të dëshirueshme sesa kjo për mua në gjithë jetën time.
- 3) Edhe nuk di a të admirosh në një bari të tillë atë hije të rëndë, a të lavdërosh dashurinë e tij ndaj të gjithëve, apo të mbetesh gojëhapur për madhërinë dhe gojëtarinë e tij, sepse ai, që t'i përmbledh të gjitha me një fjalë, për asgjë tjetër nuk shquhet më tepër sesa për spikatjen e gjithë virtyteve të veta, sepse ai jo vetëm që do

të arrijë lavdinë e të parëve, dhe të kryeveprave të tij të mëparshme, por edhe do ta kalojë dhe do ta lerë shumë prapa.

“Historia e Skënderbeut, vepër humaniste, shembull i artit të fjalës

Humanizmi ishte një rrymë e re, që lulëzoi në Evropë në vitet 1400. Ai lindi si një revoltë kundër pushtetit e unitetit fetar të kishës katolike. Për një kohë të gjatë njerëzve u ishte dashur të besonin verbërisht në teoritë fetare me në qendër Zotin dhe në pushtetin absolut të kishës katolike, derisa lindi Humanizmi.

Një ndër rilindasit e kësaj periudhe ka qenë edhe Marin Barleti, autori i “Historisë të Skënderbeut”. E gjithë vepra e tij është karakterizuar nga humanizmi, përzier me historinë, epikën e patriotizmin. Është normale që vepra e tij të jetë humaniste, sepse kryepersonazhi i saj është një **njeri real**, me vlera, i admirueshëm, sepse ka shumë për të thënë për të, për ta vlerësuar, për të nxitur ndërgjegjen kombëtare.

Skënderbeu është një strateg i shquar ushtarak, një lider i zoti, diplomat i talentuar dhe patriot i zjarrtë. Të gjitha këto janë **cilësi njerëzore**, që ai i zotëron. Fakti që autori ka zgjedhur një njeri real, një prijës për ta përfshirë në veprën e tij do të thotë se ai ka **besim te njeriu**, ka bindjen se njeriu mund të zotërojë cilësi të rralla. Gjithashtu, është hera e parë që letërsia ka figura historike të vërteta, ç’ka trgon për **vendin që zë historia në letërsi**.

Barleti është një përfaqësues i Rilindjes që solli përmbysje të mëdha të letërsisë së vjetër. Ai jetonte në Itali, në djepin e Humanizmit, prandaj edhe frymëzimi ishte i madh. Në veprën e tij, ai vë **në qendër njeriun, i cili e ka vetë në dorë fatin e tij**. Autori bazohet te **vërtetësia** dhe synon **konsolidimin e ndërgjegjes së një kombi**, si njësi më vete. Përveç kësaj, ai është një **mjeshtër i artit të fjalës**.

E gjithë vepra është e pasur me mjete stilistikore të shumta, me fjalë e shprehje të bukura. Është i përdorur **apostrofi**, figurë e intonacionit poetik, i cili i jep ritëm veprës. Një tjetër figurë letrare mjaft e përdorur nga Barleti është **enumeracioni** ose renditja e gjymtyrëve homogjene. Kjo e bënë tekstin e tij më të plotë, më të qartë. Një shembull i përdorimit të tij është fjalia: *I lumtur pra, jam unë, që po të shikoj ty sot, po të drejtoj fjalën, po të admiroj dhe s’mund të kishte gjë më të këndshme, gjë më të dëshirueshme sesa kjo për mua në gjithë jetën time*. Përveç këtyre, autori ka preferuar të përdori **antitezat e kuptimit, krahasimet** si dhe të shfrytëzojë **zhvendosjen artistike**, për ta bërë veprën sa më tërheqëse e më të pëlqyeshme.

Në fund të fundit ia ka arritur qëllimit. “Historia e Skënderbeut” ka shërbyer si një ndihmë e madhe për shkencën e historisë. Ajo është një vepër tipike humaniste, me një fjalor artistik të veçantë, të depërtueshëm në shijet e lexuesve.